



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/03-52520 dt. 20/10/ 2023

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **27.10.2023** (E premte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.09.2023.
2. Raporti Financiar Janar-Shtator 2023.
3. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e caktimit të normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024.
4. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite për pronën e paluajtshme të komunës me procedurë të negocimit të ofertës të kompanisë "Frida's Farm"
5. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite për pronën e paluajtshme të komunës me procedurë të negocimit të ofertes të kompanisë "TDI Balkans"
6. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba.
7. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Xhevat Qorri.
8. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Anita Kastrati.
9. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Lirije Prenku.
10. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Liridon Hasani.
11. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Dorentina Shehu.
12. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Sabahate Gashi.
13. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Argjira Gjinofti.
14. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Viola Dibrani.

15. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Valdrin Istogu.
16. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Taulant Mziu.
17. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Rijon Ramadani.
18. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Gentian Bujupi.
19. Të ndryshme.

Drenas, 20.10.2023



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit



Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 20.10.2023, si vijon:
Sot u mbajt mbledhja e Komitetit për politikë dhe Financa, mbledhjen e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari ndërsa merrnin pjesë Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, drejtor të drejtorive komunale dhe anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa. Kjo mbledhje kishte në rend ditë gjithsej 17 pika, ku rekomanduan më shumicë votash për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal, në mbledhje Kryetari rekomandoj që në mbledhjen e Kuvendit me hy në rend dite edhe procesverbali lidhur me çështjen e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim përmes negocimit, për projektin "TDI Balkans", z Iftach Ben Shlomo dhe përfaqësuesit të kompanisë "Frida's Farm" znj. Nicole Kuerten.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 20.09.2023.
 2. Raporti Financiar Janar-Shtator 2023.
 3. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e caktimit të normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024.
 4. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba.
 5. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Xhevat Qorri.
 6. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Anita Kastrati.
 7. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Lirije Prenku.
 8. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Liridona Hasani.
 9. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Dorentina Shehu.
 10. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Sabahate Gashi.
 11. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Argjira Gjinoftci.
 12. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Viola Dibrani.
 13. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Valdrin Istogu.
 14. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Taulant Mziu.
 15. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Rijon Ramadani.
 16. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Gentian Bujupi.
 17. Të ndryshme. Meqë nuk pati diskutime tjera mbledhja përfundoi rreth orës: 10:30
- Drenas, 20.09.2023

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari





Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04 51861 dt. 18.10 2023

PROCESVERBALI

Të mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **27.09.2023**
e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 25 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD).

Të pranishëm ishin edhe **Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Nënkryetari i Komunës Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, përfaqësues të KFOR-it zyra e informimit, qytetar.**

Mbledhja filloi punimet me këtë rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i datës 31.08.2023.
2. Propozim vendimi i buxhetit të Komunës për vitin 2024 dhe parashikimi i buxhetit 2025-2026.
3. Raporti i Progresit për Implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2022.
4. Propozim vendim për ndarjen e parcelave kadastrale.
5. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare.
6. Propozim vendim për miratimin e projekt rregullores të programit komunal tre vjeçar për banim për periudhën 2023-2025 për Komunën e Glogocit.
7. Propozim vendim për ndryshim plotësimin e rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Drenasit
8. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoha.
9. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Drilona Krasniqit.
10. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Vanesë Avdullahu.

11. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Valmire Xhema Krasniqi.
12. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Shqiprim Hykolli.
13. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Egzona Rrustaj.
14. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Kaltrina Gashi.
15. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Arton Hasani.
16. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Teuta Kuliqi.
17. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Ganimete Ramadani.
18. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. 31.08.2023, ku për diskutim ishin 18 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal.

Milaim Hajdari Kryesues: hapi punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku njoftoi me rendin e ditës. Fillimisht më lejoni që ju ftoj për një minutë heshtje në nderim të policit heroit të fundit të Kosovës, Afrim Bunjaku, i rënë në mbrojtje të sovranitetit të vendit. Lavdi!

Të nderuar Të pranishëm!

I nderuar kryetar, nënkryetar, të nderuar drejtorë, të nderuar anëtarë të Kuvendit, të nderuar përfaqësues të KFOR-it, të nderuar të pranishëm.

Po fillojmë mbledhjen në rregull të Kuvendit të komunës, ku ju njoftoi me rendin e ditës, njoftoi se Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Ganimete Ramadani është tërheqë nga kërkesa për subvencionim. Nëse jemi të qartë me rendin e ditës, një plotësim që kanë qenë vetëm po sqarona nëse mundem, fillimisht janë dorëzuar dy propozim-vendime për realikim të mjeteve, ndërsa pastaj ka qenë domethënë ndryshim teknik, është përcjellë në propozim-vendim vetëm për Rialikim të mjeteve financiare do të thotë një propozim-vendim.

Egzona Tërdevci: Në emër të grupit të asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje kam propozim që disa pika të shtyhen e disa edhe të hiqen nga rendi i ditës.

Po filloj me pikën shtatë, që është: Propozim-vendimi për ndryshim-plotësimin e Propozim vendim për ndryshim plotësimin e rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Drenasit, si asambleiste, jam anëtare e këtij Komisioni nga Lëvizja Vetëvendosje.

Kam qenë pjesë e procesit, tashmë i kemi përfunduar të gjithë, përveç fshatit Abri dhe fshatit Tërdec, i cili ka dështu për shkak të kuorumit.

Unë propozoj që kjo rregullore të ndryshohet në një fazë tjetër, duke qenë se ka mbet vetëm një fshat dhe mandati i këtyre që janë zgjedhur është për katër vjet, nuk besoj që është e nevojshme që në këtë fazë të ndryshohet Rregullorja, duke pas parasysh që regjistrimi i popullsisë do të bëhet në nëntor dhe në nëntor do të kemi një pasqyrim më të qartë se sa banori ka secili fshat.

Në këtë rregullore, tek pika numër tetë, draft-propozimi për ndryshim-plotësim të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, ju lus që me mirëkuptim ta sillni një seancë tjetër, duke

qenë se për këtë Rregullore nuk është mbajtur fare konsultim publik, një rregullore e tillë të kalojë pa konsultim publik me grupet e interesit, për bindjen tonë është tepër e paarsyeshme, si dhe në thirrjen që është bërë arsyetimi i një udhëzimi administrativ i MMPH-së, udhëzimi katër katërmëdhjetë dy mijë e pesëmbëdhjetë, tashmë veç është i shfuqizuar.

Edhe nëse do të miraton një rregullore të tillë, besoj që do të kthehej prapa nga MAPL-ja për shkak të këtij gabimi.

Tek pjesa e subvencioneve unë kam kërkuar dje nga ë kryesuesi i Kuvendit Komunal të na sjellë materialet.

Neve na është sjellë një material vonë, por nuk është ajo çfarë e kemi kërkuar.

Pasi që për pikën prej nëntë deri në shtatëmbëdhjetë është vetëm emri i përfituesit dhe ai ka plotësu kriteret, po në asnjë nga këto projekte nuk e kemi të qartë idenë.

Nuk mundemi që mjetet e qytetarëve, mjetet e taksapaguesve t'i ndajmë në këtë mënyrë.

Po i besojmë Komisionit, ndoshta jemi plotësu me të vërtetë të gjitha kriteret, por si asamblesë kur ndajmë shumën të tilla edhe ne duhet të kemi të qartë ideat për të cilat po votohet.

Nuk mundemi t'i ndajmë nga një mijë e gjashtëqind euro për secilin përfitues, pa e pas edhe ne parasysh projektin për të cilin kanë aplikuar këta.

Propozoj që kjo pikë të na vijë në seancën tjetër me përditësimet që i kemi kërku.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:

Kërkesa e Egzonës për pikën shtatë edhe unë jam pajtimi pajtohem, është kërkesë e grupit tju ka qenë për shkak se nuk ka pasë numër të mjaftueshëm, tri herë, katër herë keni mbajtur mbledhje edhe nëse ka mbetur edhe një fshat, edhe dy fshatra, nuk ka nevojë me ba propozim-ndryshim për këtë çështje, edhe domethënë pa pas nevojë me e qit në rend të ditës, unë e terheki kete pikë të rendit të ditës.

Draftpropozimi për ndryshim, plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, se është e vërtetë ajo që e thotë se nuk ka pasë fare ndërgjim fare debat publik, edhe Rregullorja Udhëzimi administrativ e heq, doni me të kallëzu edhe nuk kemi nevojë me i maltretu njerëzit.

Ndërsa sa i përket pikave për subvencionim, besoj që Agnesa na jep përgjigjen, janë komisionet të cilat i shohin krejt dokumentet edhe e kanë domethënë është aplikacionet i kanë shqyrtu edhe e kanë përfitu edhe ashtu aq pak janë që kanë përfitu që na janë atë t'u detyru edhe një herë me bo shpalljen me apliku tjerët, sepse nuk po aplikojnë.

Ua kam spjegju edhe atë më herët edhe ka pesëmbëdhjetë mijë ë dollarë që i kanë pasur të tridhjetë tonë që nuk kanë apliku kështu, në qoftë se edhe ato dojnë me i hek nuk është najfarë problemi, por kur të fitojnë grantin, donacionin prej komunës, ata janë të obligum, komuna është obligum me i përcjellë tri vjet për pajisjet që ka me i ble për çka ka apliku.

Domethënë, në qoftë se ju kërkon me i pas aplikacionet e krejt këtyre, mendoj që e keni gabim hajdni në komision, keni drejt të vëzhgues me kanë gjashtë shqyrtimi të komisionit edhe i shihni krejt.

Janë aplikacione që i kanë dhe madh dokumenta janë publike, nuk janë të fshehta, por unë kisha thënë që me i kalu këto, sepse edhe si proces e kena na me shpenzu buxhetin të cilin e kena para të parapamë.

Pra, nga të gjithë përfituesit nuk u plotësu koto c aplikuesve që kanë apliku për me me fitu këtë subvencion.

Edhe një herë u rishpall domethënë me apliku edhe përmes kësaj mbledhje i thërras gjithë qytetarët që të aplikojnë në këto në këtë thirrje të Drejtorisë të Zhvillimit Ekonomik..

Egzona Tërdevci, veç për korrektësi, tek pika shtatë, nuk ka qenë qëndrim i grupit që mu ndryshu Rregullorja.

Neve na ka ardhë në grup propozimi prej nënkryetarit, nuk ka qenë dakordim paraprak i

Komisionit për me ndryshu atë Rregullore

Nuk është problem veç po e përmendi për korrektësi që ne nuk kemi kërku me u ndryshu Rregullorja.

E kemi përmendi shumë herë që që ne problemit të kuorumit, po nuk e kemi mendu në këtë fazë me ndryshu Rregulloren, si dhe te pika për subvencione, insistoj që ne do me pasë aplikimet, sepse paraja publike për ne është shumë e rëndësishme dhe besoj që është krejt legjitime që me ditë për çfarë lloj pajisje, për çfarë lloj ideje po i japim këto mjete komunale.

Nenkryetari i Komunës Arben Shala: Unë po e tërheqi si pikë.

pastaj ju keni kohë me debatuar edhe një herë, me shqyrtuar edhe një herë me me të gjithë anëtarët e Komisionit edhe pastaj e vendosim ma me e prur Kuvend ajo.

Beqir Kiqina:

Është e vërtetë se edhe unë kam qenë njëri ndër propozuesit e komisionit që rregullorja të ndryshohet për zgjedhjen e administratoreve të lagjeve urbane dhe fshatra, pa arsye se na ka sjellë goxha punë.

Po përveç nesh, dikush do të vjen pas nesh dhe do ta ketë më të lehtë.

Përveç kësaj, ne mund të marrim parasysh që gjatë një mandati mund të ndryshohen administratorët dhe përsëri mund të zgjedhet.

Mundet me pas nesër, mundet me pas pas një jave pas dhjetë ditës zgjedhje, për arsye se dikush nga administratorë mund të jep dorëheqje, qoftë për arsye shëndetësore, qoftë për ndërrim të vendbanimit.

Në momentin kur ndryshon vendbanimin me rregullore domethënë nuk i lejohet me ushtruar atë funksion.

Kështu që ne e kemi përfunduar punën, sepse jemi mundur shumë me qenë vigjilencë në këtë raport, por ma mirë është po besoj që një rregullore me qenë me i paraparë hapat, nuk po thonë me ndryshu përnjëherë, por në diskutim, për arsye se po mendoj që është ma e lehtë edhe për ata që do të vijnë pas nesh, por edhe për ata që mund të japin dorëheqje ose mund të ndërrojnë vendbanimin.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:

Nëse më lejohet edhe sqarim shtesë. Unë thashë po e tërheqi. Nuk është kurrë urgjente. Ulni edhe një herë Komisioni Bashkë. Nuk është e thënë me marrë vendim.

Unë po e tërheqi si pikë, pastaj ju keni kohë me debatuar edhe një herë, me shqyrtuar edhe një herë me me të gjithë anëtarët e Komisionit edhe pastaj e vendosim ma me e prur Kuvend ajo.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari: Pika shtatë: Propozim-vendim për ndryshim-plotësim i Rregullores për ndryshim plotësimin e rregullores me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në komunën e Drenasit, tërhiqet prej rendit të ditës nga propozuesi i këtij propozim vendimi me kërkesën e Egzonës, faktikisht me kërkesën e anëtarëve të Kuvendit. Ndërsa sa i përket pikës së tetë Draft propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Ju jep sqarim drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik.

Agnesë Kastrati-Bucolli:

E nderuar zonja Ierdevci, Sa i përket subvencioneve, shumë mire e sqaroi edhe kryetari, ne si Drejtori e kemi formuar komisionin që e ka shqyrtuar të gjitha aplikacionet.

Ne nuk kemi drejtë, edhe pse kërkesa juve ka qenë që t'ju dërgojmë aplikacionet e çdo aplikusi, ne nuk kemi drejtë që me dhënat personale t'ju dërgojmë juve, sepse ato përmbahet numri personal si dhe numri i biznesit.

Kështu që për korrektësi, ë kushdo prej juve që dyshon ose ka dëshirë, mundet lirisht me

ardhë në zyrë edhe me i pa të gjitha aplikimet në mënyrë fizike, por jo t'ju dërgojmë me email ose me kopje.

Azmine Bujupi-Gjoka

Edhe ne si DD kërkuam në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa që të na plotësohet një material shtesë sa i përket subvencioneve të mikrobizneseve për këto zonja që kam kërku.

Nuk është diçka e pamundshme, vetëm me tregu thamë llojin e biznesit edhe pajisjet që ka me i kanë me kërku që me i blejnë, asgjë më shumë nuk kemi me kërku, prandaj këto është dashtë me na i sjellë, e jo me na sjellë këto kopje të kërkesë letërnjoftimit edhe diçka të thjeshtë që keni dërgu.

Domethënë, na kena kërku me thjesht me na tregu cili është lloji i biznesit, kurrëgjë më shumë.

Edhe nuk di pse po ju duket shumë e rëndë kjo për me na tregu çka, ne duam me ditë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:

Azmine për juve e kanë e qartë në Komitet për Politikë dhe Financë, ju kena bërë shumë të qartë dhe kena diskutu shumë të gjatë për këtë çështje..

Nuk ka problem me shtyrë edhe një mbledhje votimin e këtyre përfituesve.

Nuk ka diçka që nuk është transparente në rregull.

Janë komisionet e vlerësimit që mbajnë përgjegjësi penale, në qoftë se kanë bo lshim a diçka.

As unë s'mbaj përgjegjësi, unë muj me mbajtë përgjegjësi politike, me thanë me me gjyku politikisht, por përgjegjësi penale e marr komisioni direkt.

Ata kanë me blejë pajisje me çdo mjete që na ia ndajmë edhe me mjete edhe ata vetë. Ne e kemi në obligim një komision me bo tri vjet me i përcjellë a ka zhvillon qa të biznese a i ka i kaq ato pajisje, të cilat i ka deklarë që ka me i ble edhe që i dhomë na parë.

Tri vjet e kemi përgjegjësi, me verifiku, a i kanë ende te njejat paisje apo jo.

Azmine Bujupi-Gjoka:

Ne nuk jemi kundër subvencioneve, jemi për me i dhënë subvencionet, mirëpo ne kemi kërku thjesht vetëm titullin e çati i biznesit, asgjë më shumë.

A është frizër, a është rrobaqepës apo ë çka do tjetër.

Vetëm titullin, asgjë më shumë.

Edhe ju jeni pajtu me këtë në mbledhjen për Komitet dhe Politik dhe Financa.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:

Titujt i kemi në shpallje publike.

Po them unë po ju kërkoj pika me mbet me votu, në fakt derisa të vijë te kjo te këto pika, unë po i kërkoj Drejtorisë me ja ofru me ja ofru ato që po i kërkon, nëse është, e mundur.

Unë e tërheqi pikën e shtatë të rendit të ditës:

sepse nuk ka hi në votim, po e tërheqi unë..

Pikën tetë po e shoh unë domethënë, në qoftë se i ka plotësu të gjitha kriteret për me kanë në rend të ditës, edhe nëse Ministria e na e kthen vlerësimin pozitiv, vazhdojmë, nese nuk i ka plotësu te gjitha kriteret kerkoj me terheq.

Egzona Tërdevci: Në parim nuk kemi kundërshtim me Rregulloren, por nëse është thirr në një Udhëzim administrativ të gabuar, i cili është, po e lëmë që është gabim teknik, se kur punohet në një volum të tillë punës është krejt e mundshme me pas gabime teknike, po ai Udhëzim është shfuqizim, nuk mundet me u thirrë Rregullorja në atë Udhëzim. Ka edhe gabime teknike, kështu brenda, edhe vazhdoj me insistu në emër të grupit që nuk ka sens me u ndërru një rregullore e tillë pa pas konsultim publik, nëse jemi brenda afateve kërkoj kohe shtesë t'i bëjmë përmirësimet dhe ta sjellim prap në kuvend.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: edhe unë kerkoj që edhe kjo pikë me u shty për një seance tjetër.

Milaim Hajdari

Kryetari i ka tërheqë dy pika.

Pika e shtatë: Propozim vendim për ndryshim plotësimin e rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Drenasit. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

E është tërheqë edhe pika e shtatëmbëdhjetë që është propozim-vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Mikro-Biznesi dhe Startup të projektit të Ganimete Ramadani, dmth kjo është tërheqë në bazë të kërkesës së përfitueses.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës me ndryshimet te cekura me lart.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i datës 31.08.2023.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar, **(Për)** votuan 28 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua procesverbali.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **2. Propozim vendimi i buxhetit të Komunës për vitin 2024 dhe parashikimi i buxhetit 2025-2026.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:

Sot këtë mbledhje pres nga ana juaj që të votoni Buxhetin e Komunës së Drenasit, buxhetin më të madh ndonjëherë që ka pas Drenasi.

Për të arritur deri te miratimi i buxhetit, komuna ka ndjekur të gjitha hapat ligjor që buxheti të jetë sa më gjithëpërfshirës për të mirën e qytetarëve.

Nga muri maj, kur kemi pranë qarkoren e parë buxhetore, nga Ministria e Financave kemi bërë thirrje publike për të gjithë të interesuarit, profesionistët, për të kontribuar në planifikimin e Buxhetit për vitin 2024 dhe projeksionet për vitet 2025-2026. Pastaj, në muajin qershor, kur kemi pranë qarkoren tjetër nga Ministria e Financave, kemi mbajtur dëgjime publike për kornizën e afatmesme buxhetore, dokument ky që pas konsultimeve me qytetarë, ekspertë, OJQ, administratorë të gjithë të interesuarit është votu në këtë mbledhje të Kuvendit për

pranë mujnë korrik.

Me pesëmbëdhjetë gusht kemi pranë qarkoren nga Ministria e Financave, kemi bërë orarin dhe kalendarin në dëgjime buxhetore dhe kemi diskutu me të gjitha grupet e interesit të Buxhetit për vitin dy mijë e njëzet e katër me gra, biznese, studentë, OJQ, fermerë, grupet të marzinalizuara dhe pastaj dëgjimet buxhetore i kemi zhvendosë në bashkësi lokale, ku me prani të qytetarëve të secilës fshat është diskutu draft I ista e Investimeve Kapitale dhe Buxhetit në tërësi.

Për të gjitha këto dëgjime është hartu procesverbal dhe raport përmes të cilëve dëshmohet se kërkesat e qytetarëve janë marrë seriozisht dhe janë përfshirë në Buxhet për vitin dy mijë e njëzet e katër.

Sipas tij kalendarin, të dëgjime buxhetore edhe Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur dëgjim të veçantë me qytetarët.

për të për të pas gjithë këtij filtrimi të dëgjimeve, ku prioritet ka qenë qytetari dhe kërkesa e tij.

Pra, para jush paraqesim këtë Buxhet për miratim dhe kërkojmë nga secili prej jush të kontribuojë dhe të japë votën e tij për qytetarin e Drenasit.

Dua të shtoj se Grupi i Vetëvendosjes ka pas dy kërkesa:

kërkesën për financim të lehonave për njëqind e shtatëdhjetë euro mujore dhe për financim të njëhershme dhe për financimin e çerdhe vepër familjet e çerdhe private, për për familjet që kanë fëmijët në çerdhe.

Unë e kam shqyrtu këtë ë kërkesë, ë por ë subvencionimi, mjetet që i ke nëse shuma, podi i shumës është shumë i vogël, e kemi di e shqyrtu edhe një herë me Drejtorin e Financave, unë e kam shumë të vështirë se nga cila drejtori me i nda me i zvogëlu shumat, për me mujt me bo shumë numrin e lehonave për vitin dy mijë e 2022, tashmë e dimë, sepse kam marrë ë raport nga Agjencioni i Statistikave.

Sipas informacioneve kemi tetëqind e gjashtëdhjetë e tri lehona për dymijënjëzet e dytën, qysh ma ka dhënë Agjencioni i Statistikave, ndërsa për numër të çerdheve, nevoja e kërkesave e kena shumë shtirë.

Mund ta diskutojmë këtë çështje me ju gjatë e gjatë.

Në qoftë se gjejmë gjuhë të përbashkët, unë jam por në qoftë se nuk gjejmë gjuhë të përbashkët, ju kërkoj me votu ashtu qysh e keni para vetes.

Arbër Halilaj:

Për rikujtim dhe informim të qytetarëve, nuk është e tepërt të theksoj se Qeverisja lokale është e ndërtuar fuqishëm mbi parimin e decentralizimit, subsidiaritetit dhe pjesëmarrjes aktive qytetare në punët e organeve komunale dhe në vendimmarrje. Parimi i decentralizimit të pushtetit është parim thelbësor mbi të cilin ngrihet dhe funksionon qeverisja vendore.

Demokracia lokale dhe debati cilësor e përmbajtësor rreth politikave buxhetore komunale, që sot në rend dite e kemi Draft-buxhetin komunal 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025-2026. hyn tek parimi i decentralizimit financiar që nënkupton ushtrimin e pushtetit financiar nga niveli lokal, duke i dhënë atij autoritetin e administrimit të të hyrave dhe shpenzimeve, meqë është autoriteti publik më i afërt me qytetarët.

Miratimi i buxhetit dhe projekteve investive është kompetencë ekskluzive e Kuvendit të komunës, të cilën nuk mund ta delegojmë tek ndonjë organ tjetër. Data kur Komuna duhet të dorëzoj propozim-buxhetin dhe kërkesat për ndarjet buxhetore është 30 shtatori i vitit aktual fiskal, prandaj po e shqyrtojmë sot.

Sipas LIGJIT NR. 03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCIVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË, procesi ka shkuar ashtu që na është dërguar qarkorja e brendshme buxhetore nga ZKF dhe pastaj kërkesat për ndarje buxhetore janë inkuorporuar në Propozim-buxhetin Komunal, i cili pas miratimit nga Kryetari i Komunes, është prezentuar në Kuvendin

Komunal. Jane organizuar debatet publike me qytetar, ku janë dëgjuar kërkesat e tyre dhe mundësia që të përfshihen në propozim-buxhetin komunal.

Në fakt, përkundër asaj që në aspektin ligjor janë zbatuar obligimet për planifikimin e politikave fiskale dhe financiare të Komunës sonë për vitin 2024, në aspektin përmbajtësor mendoj që ngec pjesa e involvimit më të madh të qytetarëve, OJQ-ve, shoqërisë civile dhe organizatave e shoqatave tjera, grupeve të nënpërfaqësuar dhe palëve të ndryshme të interesit përmes pjesëmarrjes në dëgjimet buxhetore, ku do të jepnin kontributin e tyre në planifikimin, hartimin dhe implementimin e buxhetit, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Kjo siguron edhe transparencë dhe llogaridhënie më të madhe buxhetore dhe një pasqyrim më të madh të tyre në planifikimin e këtij buxheti, prandaj për këtë masovizim të pjesëmarrjes do të duhej të angazhohemi të gjithë dhe të provojmë edhe forma tjera komunikimi me qytetarët dhe ndryshime në mënyrën e organizimit të këtyre dëgjimeve.

Dëgjimet publike janë proces demokratik në drejtim të transparencës dhe qeverisjes së hapur lokale, ku institucionet publike aktivisht kërkojnë dialogim, informata dhe reagime nga publiku i gjerë rreth politikave dhe nismave legjislative me rëndësi për komunitetin.

Poashtu, ne nuk jemi pajisur me një Raport të detajuar nga këto dëgjime, ku do të shihnim listën e kërkesave dhe implementimin ose jo të tyre në planifikimet buxhetore, e të cilin do të duhej ta kishim para se të shqyrtonim buxhetin sot. Mangësia tjetër që e ulë nivelin e besueshmërisë para qytetarëve është teknike, ku dy apo tri projekte në lokalitete të ndryshme evidentohen me një kod buxhetor.

Mendoj se duhet të jemi strikt edhe në kërkesat ligjore për Raportime tremujore, që shpresoj se do të jenë përmbajtësore dhe ta detajzojnë edhe më tepër planifikimin buxhetor dhe projektet kapitale, që sot po i diskutojmë në kuadër të Draft-buxhett komunal.

Si përfundim, për hir edhe të transparencës, propozoj që sot të debatojmë dhe shterrojmë debatin, ndërsa vendimin final ta marrim të premtën më 29.09.2023 (pra, jemi brenda afateve). Deri atëherë propozoj që të mbahet një takim në Sallën e Kuvendit ndërmjet ekzekutivit, neve si antarë të Kuvendit dhe Kryetarëve të Bashkësive Lokale (administratorëve), ku këta të fundit do t'i sillnin kërkesat e listuara sipas prioritetit dhe pastaj të tillat do t'i inkorporonim në dokumentin final të buxhetit, duke ardhur me një Plan të Brendshëm të detajuar të investimeve. Unë besoj se në këtë formë jo vetëm që tregojmë decentralizim të vendimmarrjes, por edhe nuk do t'i hynim në hak asnjë lokaliteti, e aq më pak t'i japim mundësi ekzekutivit që në mënyrë autoritare të investojë në një lokalitet ose tjetrin, e duke e ditur që vendimi merret nga ne asambleistët.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:

Arbër, e para vonë ti s'ke marrë pjesë as në dëgjimin buxhetor që e ka organizu Komiteti për Politik e Financa.

Nuk ke marrë pjesë as në dëgjime tjera, kështu që më vjen shumë keq me çka i adresohesh qytetarëve, sot buxheti ose votohet ose nuk votohet.

Nuk mujta me të dëgju krejt fjalimin, për shkak të diskutimit që e bota me grupin e VV, unë jam për bashkëpunim, me të gjitha grupet, se është në interes të të gjithë qytetarëve.

Kështu që ç'ju ftoj me debat për buxhetin edhe ju ftoj me e votu buxhetin sot.

Ligjërisht, unë e kam kry detyrën tim, sepse në kohë, sipas ligjit, ia kam dorëzuar Kuvendit buxhetin tridhjetë ditë përpara dhe e keni pas në debat, në diskutim, kështu që unë nuk kam më çka shtoj.

Arbër Halilaj:

Është shkurt nuk bie unë kanë dëgju kryetari.

Unë thashë propozoj, kam drejtë me propozu, sepse përfaqësoj një subjekt politik. e rëndësishme është që të rrisim sidomos pjesëmarrjen e qytetarëve, sepse buxheti planifikohet prej poshtë lart dhe do të inkorporohen propozimet e tyre dhe nuk ka pas pjesëmarrje përmbajtjesore as të qytetarëve.

Kështu që unë thashë propozoj dhe si anëtar i Asamblesë kam drejtë me propozu.

Ju mund ta vendosni në votim dhe votojmë votojmë secili sipas bindjes tona.

Florentina Elezi:

Ashtu siç edhe kryetari e cekti që ne si Grup i Vetëvendosjes kemi kërku dy propozime, njëra prej këtyre ka qenë që subvencionimi i çerdheve për prindërit me të ardhura të ulëta, ndërsa e dyta ka qenë subvencionimi për lehonat, ndërsa asnjëra prej këtyre nuk janë marrë parasysh dhe asnjëherë nuk kemi nuk kam pas asnjë email ose thirrje me thanë hajde të diskutoj na se çka mujna me bo, ndërsa sot na erdh një ofertë që ndoshta mujna me diskutu me bo diçka, e që po më duket që është shumë vonë, nuk e di se a kemi me mujt me me bo diçka për një kohë kaq shkurt, përderisa ndoshta ankon tre muj ose ma shumë që kena pas hapësirë për diskutime.

Përveç kësaj, ne nuk pajtohemi edhe me pjesën ku janë dy-tri fshatra me një kohë të keq shqetësim, e kam ngritur edhe në Komitetin për Politikë edhe Financa.

Për mendimin tim këtu nuk ka transparencë dhe ka hapësirë për keqpërdorime, përderisa për shembull tri fshatra janë asfaltimi dhe shuma njëqind mijë euro, ndërsa shumë lehtë ekzekutivi mundet nëntëdhjetë mijë euro me i dërgu me një fshat dhjetë mijë me dy fshatra tjera, për shkak se na ia japim atë hapësirë në qoftë se votojmë pa një plan të brendshëm, të cilin insistoj me vite që me qenë një plan i brendshëm, për afërsisht se cilat fshatra dhe cilat rrugë kanë me ushtru ose cili kanalizim ka me u ba.

Në qoftë se ne votojmë kështu, atëherë nuk kemi edhe në çfarë forme me i monitoru ë buxhetin se ku po shkon, sepse ne veç po i japim hapësirë për keqpërdorime.

Kam insistu në Komitetin për Politikë edhe Financa, ku kam kërku një plan prej secilës drejtori, por që kanë hezitu ose kanë thënë nuk e kemi me atë plan.

Kështu që për mua është shumë absurde që mos me ditë pas krejt atyre dëgjime publike e mos me ditë se cili fshat sa ka me përfitu saktësisht, sepse na mujna me pas një fshat që ka nevoja shumë të mëdhaja, por ndoshta ka banuar ma pak, e nuk e di se është bërë kjo ndarje, për mua është e pakuptimtë dhe nuk mundem me votu për diçka të cilën unë, nuk personalisht si asamblist, e nuk me monitoru edhe nuk di se ku kanë me shku mjetet.

Gjithashtu dhe e kemi pranë raportin e dëgjimeve buxhetore, domethënë shumë vonë, po mirë që ka ardhë, dhe aty disa prej përgjigjeve për qytetarët kanë qenë në pakuptim, por e kanë fajësuar Kuvendin Komunal në mënyrë të pakuptimtë, kanë thënë që për shembull e shoqata e të shurdhëve ka kërku një objekt, ndërsa përgjigja ka qenë se Kuvendi Komunal e ka pa mundësu përderisa nuk e ka japë votën për me ndërtu objektin e ri.

Për mu këtu përgjigje dhe disa të tjera janë të paarsyeshme dhe të papranueshme.

Kështu që nuk e di se çka mundemi me bo, por ne si Vetëvendosje parimisht jemi kundër këtij buxheti.

Egzona Tërdevci:

E i kam me dhënë disa dilema në emër të grupit lidhur me çështjen e buxhetit.

Fillimisht është çështja e subvencioneve.

Parimisht na vjen mirë që ka një rritje të theksuar tek subvencionet për vitin dy mijë e njëzet e katër, janë rritur për shtatëdhjetë e tre mijë euro në krahasim me vitin dy mijë e njëzet e tre. Po na intereson të dimë a ka një plan të qartë për shpenzimin e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë euro që janë subvencione, po ndalem edhe unë tek çështja e dëgjimit buxhetor, ë dhe tek komentet e pavenda që janë dhënë në raport me kërkesat që janë paraqitë:

E para, dëgjimi raporti për dëgjim buxhetor është paraqitë në faqet e komunës tepër vonë, është paraqitë tek mbrëmë edhe nuk është kohë e mjaftueshme për me analizu ndoshta se cilat kërkesa pasi i kanë gjetë përkrahje te buxheti, realisht asnjë kërkesë nuk ka gjetë përkrahje, Sa i përket dëgjimit buxhetor, te kërkesa e shoqatës ë për të shurdhër që kanë kërku një objekt, jemi fajësu padrejtësisht si kuvend komunal që ne ua kemi pamundësu kur nuk e kemi votu që komuna e vjetër të jepet një shfrytëzim, po pyes se ndoshta neve na ka ikë si informacion, kur e kemi marrë projektin ideor për objektin e vjetër të komunës, se si ka pasur me shfrytëzu ndarja është kështu, arkiv të komunës, sallë e kulturës, bibliotekë, administratë, sallë e takime, veç për korrektësi, cila u kanë hapësirat që ka pasur me u shfrytëzu nga të shordhurit, se prej këtyre hapësirave asnjëra nuk po duket.

Dhe është komenti që është dhënë po ashtu tek Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave, dhe ai objekt vazhdon me qenë i mbyllur.

Ju publikisht keni thënë këtu që në rast se rrënohet objekti i komunës së vjetër, është një objekt që është tek shkolla “Rasim Kiqina” që është ndertu pikërisht për gra dhe ka me iu dhënë në shfrytëzim.

Po ashtu edhe çështjet grumbullimi i projektit, kemi kërku vazhdimisht që ta kemi një plan të brendshëm, ne nuk mundemi me votu buxhet kur nuk e dimë ku kanë mu destinu ato mjete. Po ngris edhe për të disa herë radhazi se buxheti i ndarë për ujësjellës, pra vlera vetëm dyqind mijë euro, është e pamjaftueshme.

Po ashtu, kam shqetësim lidhur me grumbullimin e projekteve për rrugë të asfaltuara që janë në vlerë pesëqind e gjashtëdhjetë mijë euro për vitin dy mijë e njëzet e katër dhe kanalizimet që janë në vlerë pesëqind mijë euro.

Cila fshatra ose cilave lagje të qytetit do t’ju ndërtohen rrugët edhe kanalizimet, meqë kështu nuk ka asnjë qartësi.

Nuk po besoj që këto pesëqind mijë euro janë të mjaftueshme për krejt kërkesat që kanë qenë nga dëgjimet buxhetore.

Unë nuk ju kam fajësu asnjëherë për numrin e vogël të pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore, po me të vërtetë i kuptoj edhe qytetarët kur nuk ndryshohet asnjë cent buxheti, pavarësisht kërkesave pse duhet me ardh, është çështja e shkollës “Rasim Kiqina” ndërtimi i parapeles të Shtrubullovës që do të ndërtohet kjo paralele, po janë ndarë veç njëzet e pesë mijë euro.

Secili prej neve këtu e ka qartë që njëzet e pesë mijë euro nuk mjaftojnë për një shkollë.

Nëse është çështja veç me e zë një këtë buxhetor, pas ne çdoherë po mbesim t’u ba ridestinin të mjeteve, sepse nuk po mundem me u kry mjetet me kohë.

E njëjta vlen edhe për ndërtimin e rrugës së bregut të Qyqavicës.

Kryetati i Komunës Ramiz Lladrovci,

Për zyrat e shumë e shurdh memeceve i kanë zyrat në objektin e Qendrës Tregtare.

As unë ua mbaj mirëmbajtjen atje, as pastrimin nuk mundem me ba, s’kam asnjë kod komuna e vjetër, për dijeni tanën, ka vendim për rrënim dhe do ta rrënojë.

Qenda për promovimin e drejtave të grave, objekti të cilin e kemi në dispozicion, jemi tu prit me e gjetë donatorët me mobilu objektin, sepse vetëm për mobilim është mbet.

Shkolla “Rasim Kicina” ose paralele e re në Shtrubullovë kemi thënë edhe në debate

gjithkund e kemi çelë kodin, e kemi bërë kodin me e ba një shkollë dhe ne shkollat vetë që ne i bëjmë duhet me nivelin qendror.

Një mbështetje e grupit tu të nivelit qendror na i bëjmë paret krejt për shkollën se duhet me ba edhe projektin.

Mjetet ose kodi për bregun e Çaviçes, unë e kam dërgu një listë të kërkesave të nevojave të komunës, të cilat nuk mund t'i përballon komuna, ia kam çu nivelit qendror dhe muj me ta përcjell edhe ty me e pas për të gjitha nevojat, për të gjitha investimet në të gjitha drejtoritë. I kam çu edhe qejf vazhdimisht edhe besoj që kam me arrite qëllimin bashkë me Qeverinë, vendon mjetet, sepse Qeveria për projektet mbaja ka obligim.

E kam dërgu, po i them disa propozime, disa projekte.

E kam dërgu projektin për rrugën e Çiçavicës, që i lidh katër komuna direkt dhe me interes të përgjithshëm.

E kam çu rrugën e Berishës, e kam çu ë parkun e pishave në Komoran, e kam çu fazën e dy pishave në Gllobar, e kam çu liqenin e Verbovcit dhe për dijeni tonën asnjë procedurë s'mund me zhvillu për liqenin e grumbullimin e ujësjesit të Verbovcit, për shkak se akoma nuk e kena vlerësimin e pronave që duhet me e ba Qeveria.

Në momentin që na e dhanë vlerësimin, na mujm me gjetë mundësi tjera me ë i gjetë mjetet për me me fillu me bo liqenin që është shumë i nevojshëm për ujë të pijes për katërdhjet mijë banorë.

Ta nis i di se unë nuk e kam për ata dhe sot diskutojmë veç për buxhetin që e kemi dhe brenda këtij buxheti se si e këna ba shpërndarjen e mjeteve.

Unë u sqarova me juve.

ju janë propozimet e juaja dhe më thatë që edhe nëse i shtin propozimet, ne nuk e votojmë buxhetin.

Pra, ma keni thënë me kohë që unë po them që edhe nëse nuk e votoni buxhetin, unë do t'jau propozoj ndryshimet për subvencionin për lehonat edhe për çerdhet me pa mundësinë domethënë me financu.

Unë do t'i veç e kam bo një listë për këtë çështje.

Egzona Tërdevci:

E ka më ba edhe një kërkesë nëse keni një plan për shpenzimin e subvencioneve, se keni qenë duke bisedu me drejtorin, janë katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë euro planifiku në subvencione për vitin dy mijë e njëzet e katër.

E di që mund të dini mos me pas plan detaj, por nëse e keni viç vija trasha se ku do destinohen këto subvencione ose për çfarë projekte do të shkojnë.

po ashtu, e ngrita edhe çështjen e buxhetit të grumbulluar për rrugë të asfaltuara që janë pesëqind e gjashtëdhjetë mijë euro dhe nuk e kemi idenë se ku kanë me qenë ato rrugë, edhe çështjen e kanalizimit ku janë pesëqind mijë euro.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:

Na nuk i dina gjatësitë e projektit, sepse kur të votohet, na e bëjmë projektin, nuk i dimë sasishtë, nuk mujna me thanë rrugën pesë kilometra po e bëjmë për dyqind mijë euro, sepse ajo mundet me kushtu ma lirë, mundet me kushtu ma shtrenjtë, sasishtë, pjerrësitë, heqja e dhut e tjera e tjera, janë këto që janë me projekt.

Ne e kena aq mjete të ndara për ato fshatra sa të mujna kryer shërbim me ato mjete.

Nuk kena domethënë projekt për një rrugë e cila kushton, dihet saktë çmimi edhe saktë sa kushton.

Nuk e kena edhe se ka kurrkush e asnjë komunë tjetër.

Ne e kena rrugën e Çiçavicës, bregun e Çiçavicës, e kena projektin detaj, e dimë saktë.

E kena rrugën e Berishës, e kena projektin e dina saktë sa kushton, e kena e Pishinën Gjysmë

Olimpikë, projektin e dina saktë sa kushton, e kena stadionin, i kena shumë projekte të cilat na nuk mujna me i përballu, sepse buxheti jonë është aq i vogël, sa cila u desh me i nda në për fshatra.

Florentina Elezi:

Unë kam ba debat me juve për këtë punë, por prapëseprapë nuk pajtohemi për shkak se pesëqind mijë euro në qoftë se a nuk dihet as fshati se ku kanë me shku, mendoj prapëseprapë se drejtoritë përkatëse do të me pasë një listë të prioritetëve, të paktën me e ditë se cili fshat kom e kanë i parë ose cili i dyti, pastaj të tjerat!

Mehedin Salihu:

I përkrahi kolegët e Vetëvendosjes, po mosvotimi i buxhetit u kthim mbrapa, mendoj unë. Më mirë të gjithë na duhet me kërku qito mjete, qitu raporte që i kanë qitë letër ekzekutivi me me kërku që me i zbatu.

Nëse këta zotojnë që kanë me i zbatu qitu, për ne ua mrekulli.

Po, trysnia jonë është që këta me i respektu edhe me i zbatu keto që ne kanë shkru.

Unë në qitu raporte pesë që jam asambles t'i shoh asfaltimi i rrugëve tri fshatra, infrastruktura për tri fshata.

Unë po du mos me u kthy mbrapa, po po du ato që ai kanë qitë letër me i zbatu.

Egzona Tërdevci:

Nëse është e mundur, kërkoj në emër të grupit që këtë propozim ta votojmë ndaras, meqë është propozim i sotshëm, ta votojmë domethanë veç propozimin që e bëni tash zotëri Lladrovci për çështjen e lehonave dhe për çështjen e çerdheve, si dhe me mirëkuptim ju lus për një pauzë pesëmbëdhjetë minuta.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:

Unë muj me ta plotësu si dëshirë fontanash edhe ta plotësoj këtë dëshirë pra me votu

Buxhetin për lehonat e për çerdhët.

Ta plotësoj këtë dëshirë, po Buxheti votohet si tërësi.

Po jo bre, po kurrkund në botë nuk e pa një grup parlamentar që thotë Po votojna veç për këtë sen, e nuk po e votojna buxhetin në tërësi, sepse ti s'e ke votu as buxhetin për lehonat.

Albulena Saliuku:

Ne kemi pas mundësinë me qenë prezentë në dëgjimet buxhetore edhe fatkeqësisht shumica e anëtarëve që pos me thanë krejt nuk kanë qenë prezentë.

Është e saktë që ka qenë vetëm kolegja asambliste, Florentina dhe unë.

Edhe kemi pas mundësi ë me i pa të gjitha kërkesat e qytetarëve edhe realisht i kemi marrë të gjitha përgjigjet qoftë nga drejtori të caktuara, qoftë edhe nga kryetari.

Nuk e shoh aspak të arsyeshme ë që mos me votu buxhetin.

Ë është gjithsesi ë në dëm të qytetarëve, meqenëse projektet veç i kemi,nuk mundemi me i ditë ndoshta me metra dhe si funksionon ajo me detaje, mirëpo buxheti është i përcaktuar për secilin projekt.

Në momentin që kryetari veç nëse mund të themi u zotu për kërkesa për lehonat edhe për çerdhet edhe sigurisht në bazë të mundësive buxhetore mundet me u baUnë mendoj që ë as pauza pesëmbëdhjetë minutëshe nuk është e nevojshme për votim të Buxhetit

Mehedin Salihu:

Unë po të qef me dëgju prej kryetarit edhe një herë që të ndryshimin, se nuk e pata shumë të qartë. Si bëhet edhe për sa kohë edhe jam për me vazhdu me votim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:

Nëse jeni të dakord me i nda 100 (njëqind euro) për gratë lehona, dhe e çeka sipas statistikave, unë Ne i kena njëzet lindje në Drenas. Ndërsa nivel vendi, sepse lindjet, gratë tona, nënat tona, motrat tona i bëjnë na për qytete në qytete tjera.

Si numër i lindjeve të reja, sipas statistikave i kena, tetëqind e gjashtëdhjetë e tri.

Ka njëqind euro bëjnë tetëqind, tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind.

Këtë shumë e kam zbrit nga shërbimet publike që i kena për shërbimet e varrimit.

I kena paraparë njëqind mijë euro, i kena lanë shtatëdhjetë mijë euro.

Na besojnë që me shtatëdhjetë mijë euro e kalojmë vitin.

Këtë shumë e kena hekë nga njëqind e tridhjetë e pesë mijë të Drejtoria e Kulturës, e kena lanë njëqind e pesë mijë.

Nga gjashtëdhjetë mijë te bujqësia e kena lanë tridhjetë mijë.

Nga gjashtëdhjetë mijë te ë zhvillimi ekonomik i kena lanë njëzet mijë, e kështu me radhë, po domethënë unë si si tërësi subvencionet i kena kalu nëse na vendosëm për çerdhe dhe për lehona, jemi në rregull dhe i kena shumë. Podin qysh e kena Po, njëqind e tridhjetë mijë është ndryshimi. Pra, ndryshimin e bëjmë dhe e kenë qit listën. Jepmë menjëherë me e pa ndryshimin veç për subvencione.

Fjala është veç për subvencione.

Nëse pajtoheni, e qesim edhe propozimin e Egzonës edhe një herë me votu. Edhe prapë ne ta votojmë subvencionin.

Buxheti në tersi kur votohet çelësi që voton që ai mundet me shku me me u lavdu të qytetarit që unë ta prona këtë mundësi, këtë projekt, këtë subvencion e tjera e tjera.

Unë po propozoj njëqind, sepse për njëqind dymijë e njëzet e katër, pra buxheti i.

Edhe për çerdhen njëjtë, për 2024, jo për vitin 2023

Tridhjetë euro për familje.

Ata paguajnë gjashtëdhjetë euro tash varet prej prej çerdhes.

Na nuk i përcaktojmë.

ATK-ja është niveli qendror që ua bën çmimet.

Na nuk i përcaktojnë as çmimet e çerdheve private.

Hamit Haxhiu:

Buxheti është pika më thelbësore për çdo planifikim nga ky Buxhet.

Unë nuk e di që po diskutohet kaq shumë për lehonat, kur dihet se ligji në fuqi është prej dy mijë e pesëmbëdhjetës dhe nuk u heq ky ligj, nuk është dmth që ka dalë prej fuqisë.

Domethënë ky Kuvend ose asamblesë të legjislativave të kalume në vitin dy mijë e pesëmbëdhjetë, diku në rend të miq dy mijë e gjashtëmbëdhjetë e kanë aprovu Ligjin për lehonat dhe ky është në fuqi.

Kryesuesi Milaim Hajdari: Dhjetë minuta pauzë!

Pas pauze:

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:

Qe ta keni të qartë që ta keni qartë se i kemi hek tridhjetë mijë këtu ku i kena shërbimin e varrimit.

Pastaj te Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i kemi lanë tridhjetë mijë, i kemi hekë

tridhjetë mijë.

Te zhvillimi ekonomik i kena pas gjashtëdhjetë mijë, i kena lanë njëzet mijë.

Te kultura, rinia dhe sporti i kena pasë njëqind e tridhjetë e pesë mijë, i kemi lanë njëqind e pesë mijë.

Te shëndetësia i kena pasë tridhjetë mijë, e dini që kena shpenzu bukur shumë këtë vit ose kena miratu shumë kërkesa, i kena njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë. Këtu hyjnë lehonat.

Pra, nuk e dimë numrin, po kjo shumë është për lehonat edhe është për ë nevojat e ë qytetarëve tonë për subvencionim për shërim.

Te arsimi i kena pas njëqind mijë për bursa, i kena bo njëqind e katërdhjetë e tre mijë e shtatëqind, ku do të përfshihen edhe fëmijët ose familje e familjet e fëmijëve që i kanë çerdhe. Këto janë ndryshimet. Listën e keni si para veti.

Po kërkoj prej kryesuesit ta votoj veç këtë ndryshim një herë, për t'ia re realizu edhe dëshirën e qëllimin grupit Vetëvendosja, pastaj e votojmë tërësi buxhetin.

Atëherë, shkojmë me votimin e propozimit të kryetarit, që faktikisht brenda kategorisë së subvencioneve.

Kishte fjala njëqind euro për njëqind euro për lehona dhe tridhjetë euro për fëmijë për çerdhe. Shkojnë me votimin e këtij propozimi ndryshimi a çka po i vjen tash?

Milaim Hajdari Kryesues:

Meqë nuk pati diskutime tjera pas rekomandimeve të dhëna nga asambleja me dy propozimet e kryetarit për financim të lehonave dhe për subvencionim të fëmijëve të familjeve me të ardhura nën 500 euro kryesuesi hodhi në votim këto dy propozime: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 29 anëtar kundër nuk pati, 1 abstenim.

Florentina Elezi-Veliu:

E falënderojmë shumë ekzekutivin që e kanë marrë parasysht propozimet tona edhe që i kanë fut në buxhet.

Shpresoj shumë e ftoj edhe Kuvendi Komunal normal me na e mbështetë me votë dhe shpresoj që bashkërisht kemi me ba punë të mira në vitin dy mijë e njëzet e katër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Raporti i Progresit për Implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2022.**

Shyqiri Bublaku-Drejtor i Financave:

Ky raport i progresit për implementimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit është si obligim ligjor i komunës së Drenocit dhe i cili duhet të qitet si raport në mbledhjen e Kuvendit Komunal, ku nga dhjetë rekomandimet, pesë janë zbatuar tërësisht, pjesërisht janë. Tri një është në proces.

Kjo kish me qenë në pika shkurtra sa i përket raportit të progresit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për ndarjen e parcelave kadastrale.**

Meqë nuk pati diskutime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë e të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për rialokim të mjeteve financiare.**

Meqë nuk pati diskutime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar, **(Për)** votuan 25 anëtar, kundër nuk pati, 4 Abstenim u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë e të rendit të ditës: **6. Propozim vendim për miratimin e projekt rregullores të programit komunal tre vjeçar për banim për periudhën 2023-2025 për Komunën e Gllogocit.**

Egzona Tërdevci:

Raporti i DSHMS-së për numrin e lindjeve, po konsideroj që është dashtë me i përfshijë krejt lindjet që janë ba në bazë të regjistrimit, jo veç lindjet në QKMF, se na e dimë që lindjet në QKMF udhëzohen, veç për Prishtinë janë veç gjashtë lindje.

Nuk mund me marrë shumë për bazë si si vlerësim këtë çështje.

Pastaj është tek numri i çerdheve, e keni cek që janë veç dy institucione private parashkollore, ne të gjithë këto e dimë që janë më shumë sesa dy, po ata mundet me marrë dikush për bazë, jo nuk është e rëndësishme me më lidhur me këtë raport, po është tepër e rëndësishme me pasë numrin e saktë të institucioneve parashkollore që funksionojnë brenda komunës sonë.

Parcela për të cilën e kemi nda para dy seancave ndoshta për ndërtimin e një objekti të banimit social, me aq sa unë kam informacion ajo nuk është për banim social në kuptimin e familjeve me asistencë sociale, apo bëhet fjalë për planprogramin e qeverisjes së Lëvizjes Vetëvendosje që është banesa për çiftet e reja.

Nëse jeni tu llogaritë në atë, për korrektive me e qartësu a jeni tu e llogarit edhe atë objekt apo jo?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:

Ne e kena da për banim social pronën dhe u zotu qeveria me ba një ose dy objekte, pra të banimi social.

Meqë nuk pati diskutime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, **(Për)** votuan 23 anëtar, kundër nuk pati, 4 Abstenim u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e 7 dhe pika 8 janë tërheq nga rendi i ditës.

Pauzë 1 orë!

Pas pauze.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nëntë e të rendit të ditës: **9. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Drilona Krasniqit.**

Meqë nuk pati diskutime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 17 anëtar, **(Për)** votuan 16 anëtar, kundër nuk pati, 1 Abstenim u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dhjetë e të rendit të ditës: **10 . Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Vanesë Avdullahu.**

Meqë nuk pati diskutime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 17 anëtar, **(Për)** votuan 17 anëtar, kundër nuk pati , Abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë e të rendit të ditës: **11. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Valmire Xhema Krasniqi.**

Meqë nuk pati diskutime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 17 anëtar, **(Për)** votuan 17 anëtar, kundër nuk pati , Abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë e të rendit të ditës: **12. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin e Shqiprim Hykolli.**

Meqë nuk pati diskutime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 17 anëtar, **(Për)** votuan 17 anëtar, kundër nuk pati , Abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë e të rendit të ditës: **13. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Egzona Rrustaj.**

Meqë nuk pati diskutime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 17 anëtar, **(Për)** votuan 17 anëtar, kundër nuk pati , Abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërbëdhjetë e të rendit të ditës: **14. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Kaltrina Gashi.**

Meqë nuk pati diskutime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 17 anëtar, **(Për)** votuan 17 anëtar, kundër nuk pati , Abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pesëmbëdhjetë e të rendit të ditës: **15. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Arton Hasani.**

Meqë nuk pati diskutime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 18 anëtar, **(Për)** votuan 18 anëtar, kundër nuk pati , Abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtëmbëdhjetë e të rendit të ditës: **16. Propozim vendim për financim të projektit nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për Mikro Biznese dhe Start-up në projektin Teuta Kuliqi.**

Meqë nuk pati diskutime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 18 anëtar, **(Për)** votuan 18 anëtar, kundër nuk pati, Abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtëmbëdhjetë e të rendit të ditës: **17. Të ndryshme.**

Drejtoresha e Shëndetësisë Lumnije Krap:

Ditë më parë i kam pranuar disa pyetje nga subjekti i Vetëvendosjes.

Jam munduar në aspektin e procedurave ligjore t'ju dhamë përgjigje. Po fillojmë nga pyetja e parë.

Pyetja e parë: Më është adresuar konkurset në QKMF, në thelb të veçantë, konkursin për infermieri. Të nderuar, procedurat e konkursit të QKMF-së të konkurseve të QKMF-së zhvillohen në pajtim me legjislacionin në fuqi, në bazë të ligjit për zyrtar publik. në bazë të Udhëzimit Administrativ që i rregullon procedurat e konkursit për sektorin publik dhe nenit tetë të Ligjit të 03/2012.

Kjo është përgjigja sa i përket pyetjes së parë.

Pyetja e dytë: Funksionimi i urgjencës në kuadër të QKMF-së.

Urgjenca funksionon në dy njësi: QKMF në Drenas dhe QMF në Komoran.

Në QKMF në Drenas në urgjencë dhanë shërbime katër ekipe dymbëdhjetë prej dymbëdhjetë orësh plus të vikendeve e kemi tri ekipe të mjekëve në ndërrimin e natës.

QMF në Komoran po ashtu punohet me tri ekipe me ndërrimin e natës dymbëdhjetë orë dhe për vikende njëzet e katër orë.

Ndërsa nga data një tetor do të vazhdojmë me në QMF në Komoran, do të ndryshojë orarin nga tri ekipe në katër ekipe, domethënë punohet njëzet e katër orë me ndërrime dymbëdhjetë orësh.

Pyetja tjetër që është adresuar është se si funksionon laboratorit në QMF dhe a janë marrë masa disiplinore për personat që nuk kanë respektuar vendin e punës.

Në shërbimin e laboratorit punon çdo ditë në QKMF në Drenas dhe në QMF në Komoran, bazuar në Udhëzimin Administrativ zero katër dy mijë e njëzet.

Nga një tetori në QKMF në Drenas do të fillohet të punohet edhe me ndërrimin e pasdites për rastet urgjente deri në orën njëzet.

QMF në Drenas dhe QMF në Komoran janë të aplikueshme gjithësej njëzet e shtatë ë analiza të cilat aplikohen sipas referimit të mjekëve dhe sipas Udhëzimit Administrativ 2020, po ashtu në AMF aplikohen gjashtë analiza.

Si njoftim lidhur me furnizimin me analiza, tash e kemi një kontratë të nënshkruar kontratë dy mijë e njëzet e tre-njëzet e pesë që kemi material të mjaft mjaftueshëm për këto analiza që janë të aplikueshme në QKMF si e theksova dhe ma herët e kemi njëzet e shtatë analiza të aplikueshme.

Në procedurat e prokurimit e nënshkrimit jemi të projekti për blerjen e aparaturave për analizat tjera biokimike dhe imunologjike.

Me furnizimin e këtyre e këtyre aparaturave do të arrijmë standardin në bazë të Udhëzimit Administrativ, domethënë që do të bëhen të gjitha analizat në në QKMF Drenas dhe QMF Komoran.

A respektohet a janë marrë masat?

QKMF tashmë e ka të aprovuar një rregullore të brendshme me që është aprovuar nga Këshilli i Drejtuesit të QKMF-së, 14.07.2023 për mosrespektimin e detyrave në vendin e punës, domethënë çdo zyrtar ose çdo punonjës shëndetësor që bie ndesh me rregulluar në brendshme të QKMF-së, normalisht që merren masa disiplinore.

Nuk du me cek për masat që janë marrë, po kush është domethënë zhvillimet e fundit që kanë ndodhur, domethënë janë marrë masat për secilin në bazë të Rregullores.

Sa mjekë aktualisht pyetja tjetër me është adresuar?

Sa mjekë aktualisht janë në QKMNP?

Aktualisht në QKMF në Drenas dhe QMF dhe AMF gjithsej kemi pesëdhjetë doktorë të mjekësisë familjare dhe specialistë.

Mirëpo, në mbështetje të nenit 8, të Udhëzimit Administrativ 04/2020 në kujtesën parësor shëndetësor dhe në bazë të nenit shtatëmbëdhjetë e specifikon si një ekipë e mjekëve një mjek dhe dy infermierë, domethënë i përfshin dy mijë banorë.

Tash edhe numri i mjekëve, specialist edhe doktorët varet prej numrit të banorëve se sa banorë i kemi në Komunën e Drenasit.

Cila është gjendja në QMF Komoran dhe në AMF të Komunës së Drenasit?

Në QMF Komoran, në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Komoran ofrojmë shërbime njëzet e katër orë, janë të aplikueshme të gjitha shërbimet që ofrohen në QKMF në Drenas, përjashtimisht administrata dhe shërbimi gjinekologjik.

Gjithashtu, sa për njoftim, para pak kohësh e kemi hapur edhe barnatoren në Institutin e QKMF-së në Komoran.

Jemi në procedura të nënshkrimit të kontratës për kontratës për karriget stomatologjike. në afatin domethënë brenda afateve ligjore kur nënshkruhet kontrata dhe ë furnizohet me karika stomatologjike, atëherë do ta hapim shërbimin e stomatologjisë edhe në QMFK Komoran edhe në Arllat dhe në tërës tani gati jemi në hapje.

I kemi marrë procedurat e hapjes, meqenëse një karrige stomatologjike ka ardh në donacion nga një qytetar, të cilin falënderojmë.

gjithashtu gjithashtu janë përfunduar të gjitha procedurat e shërbimit radiologjik të reangenit në QKMF, vetëm se jemi në prit jetë matjes së fuqisë së rrezatimit në repartin e radiologjisë në përfundim, në momentin ku përfundonë ky projekt, atëherë do të fillojmë edhe me shërbimin e radiologjisë edhe në Komoran.

Gjendja në qendrat tjera, në AMF tjera, muj me thanë është relativisht e mirë.

Është punuar dhe është duke punuar në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme, gjithmonë në harmoni me Ligjin me Udhëzimin Administrativ 04/2020. Të gjitha AMF-të janë të pajisur me procedurat e projektit të Pjerrinave.

Ka përfunduar instalimi në nxemjet në të gjitha që në të gjitha institucionet e kujdesit parësor shëndetësor, pra janë të instaluar në nxemjet.

Gjithashtu, jemi në procedura të DED-së, të gëlqerosjes, mandej edhe jemi rregullimi i disa nyjeve sanitare aty ku ka nevojë.

Gjithashtu, referuar udhëzimit administrativ 2020 dhe numri i punëtorëve të rekrutuar në konkursin e fundit, pas pa pas punës provuese do të fillohet edhe funksionalizimi i AMF-së në Sankoc dhe Abri.

Këto janë përgjigjet e pyetjeve të adresuar nga Grupi i Vetëvendosjes.

Egzona Tërdevci:

E vlerësoj se në një kohë të shkurtër i keni mbledhë të gjitha informatat, por shpresoj që me të vërtetë gjendja është kështu se na vazhdimisht marrim ankesa prej qytetarëve.

Nëse faktikisht do të ishte gjendja kaq e mirë, nuk do të duhej të kishim aq shumë ankesa, po për sot, po i besojmë fjalëve tua derisa të shohim punën në terren.

E kam edhe një pyetje shtesë, në fal që nuk ta kemi dërgu me shkrim, po e kemi marrë informacionin më vonë.

E kemi informacion, duket ka qenë edhe mediale, që tek AMF-ja në Bincë ka ra fasada përbrenda.

A jeni të informuar me këtë dhe a është ndëshku kompania që e ka punuar, se cilat janë masa që janë marrë?

Drejtoresha e Shëndetësisë Lumnije Krapi:

Sa i përket ankesave ë të qytetarëve, ne e dimë vazhdimisht se kemi ankesa të vazhdueshme, mirëpo të gjitha ato ankesa që adresohen pa marrë parasysh të tillë ose gjithsecili tjetër, është mirë me u adresu në vend, të caktuar edhe ne iu dhamë përgjigje ose është qashtu ose s'është. Unë e dhashë gjendjen faktike edhe çdo herë bazohemi në udhëzim administrativ dhe në Ligjin e punë, jo absolut se qytetari mundet me tha gjithçka, po duhet me ka me bazu në udhëzime dhe në rregullore.

Sa i përket AMF-së, në Baicë jam e informu dhe vetë kam dalë edhe e kam vizitu, e kam pa qysh është gjendja, meqenëse kompania e kanë që ka punu, domethënë është në ato limitet kohore, afatet kohore, e kemi adresu operatori na i ka kthi përgjigjen edhe besoj që e kryen, meqenëse ka është brenda afatit të garacionit .

Mërgim Pirraku:


Kërkoj nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik që në mbledhjen e tetorit që e kemi në Kuvend, të përpilojë të përgatisë një raport të detajuar për start-upet dhe për mikro bizneset domethënë që janë të vogla që i kena financu në vitin 2022.

Domethënë, na si Kuvend kemi marrë vendim brenda këtij Kuvendi me i financu disa mikro biznese edhe disa start up edhe kërkoj me përgatit një raport të detajuar, sepse ata kanë pasur obligim me i monitoru se a i kanë realizu planet e biznesit edhe mundësisht le të jetë një raport në detaje, për shembull nëse biznesi e ka pas në plan biznesit për me blerë një pajisje të caktuar, mundësisht le të jetë fatura që e ka blerë edhe le të jetë një fotografi e atij aparati edhe le të na tregon për shembull ato biznese a janë të funksionojnë edhe çka ka ndodhë me me to. Për secilin biznes veç e veç.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 14:15 min.

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 27.09.2023 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalën YouTube.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Glllogoc)
Zyra e Kryetarit

01/Nr. 052/01-52362 Dt. 20/10/2023



RAPORTI FINANCIAR JANAR - SHTATOR 2023

TETOR 2023

1. Hyrje

Raporti financiar buxhetor, për periudhën janar – shtator 2023, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit, nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Raporti i përgatitur nga Kryetari i Komunës, mbulon periudhë janar – shtator të vitit fiskal dhe paraqet informatën e përcaktuar, që ka të bëjë me arkëtimin, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet dhe detyrimet.

Në tabelen e mëposhtme paraqitet buxheti fillestar i Komunës për vitin 2023, sipas kategorive ekonomike të shpenzimit.

Tabela Nr.1 Buxheti Komunal sipas Ligjit Nr.08/L-066 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Përshkrimi	Buxheti	Pagat	Mall e shërb	Komunalit	Subvenc	Kapitalet	Nr.punt
Z.Kryetarit	219,225.00	157,740.00	53,485.00	-	8,000.00	-	19
Adm.person	429,481.00	236,037.00	149,444.00	-	-	44,000.00	42
Inspektorati	121,231.00	68,581.00	52,650.00	-	-	-	10
Z.Kuvendit	154,330.00	109,927.00	44,150.00	-	-	-	
Buxhet dhe finan.	121,190.00	103,889.00	18,000.00	-	-	-	16
Shërb Pub. Em.	899,895.00	164,126.00	292,269.00	165,500.00	90,000.00	188,000.00	25
Infrastruk Publike	4,365,653.00	49,758.00	26,800.00	-	-	4,289,095.00	8
Z.K.Kthim	8,676.00	7,996.00	680.00	-	-	-	1
Bujqësia	148,521.00	76,192.00	12,329.00	-	60,000.00	-	13
Planif.Zhvill.Ekon.	107,235.00	48,985.00	26,250.00	-	32,000.00	-	8
Gjeodezi dhe Kad.	94,300.00	84,150.00	10,150.00	-	-	-	13
Urbanizmi	115,554.00	48,038.00	17,517.00	-	-	49,999.00	8
Administrata Sh.	113,902.00	36,562.00	52,340.00	-	25,000.00	-	5
Kujd.Prim.Shënd	2,637,796.00	1,476,351.00	587,445.00	54,000.00	-	520,000.00	181
Shërb Sociale	143,841.00	91,961.00	42,680.00	9,200.00	-	-	14
Kultura dhe sporti	867,470.00	75,295.00	122,175.00	-	125,000.00	545,000.00	13
Adm. Arsim	387,139.00	77,139.00	230,000.00	-	80,000.00	-	12
Ars.Parafillor	232,084.00	178,053.00	47,482.00	6,549.00	-	-	22
Ars. Fillor	5,522,309.00	4,628,133.00	424,176.00	65,000.00	-	-	740
Ars. I Mesem	1,466,614.00	1,319,142.00	125,472.00	22,000.00	-	-	177
Totali I Buxhetit	18,156,891	9,038,054.00	2,335,494.00	322,249.00	420,000.00	6,041,094.00	1,368

1.1. Performanca e të hyrave

Grumbullimi i të hyrave buxhetore ka vazhduar gjatë këtij tremujori. Të hyrat tatimore dhe jotatimore kanë shënuar një rritje prej 7.28%, që korrespondon me shumën prej: 66,094.08 € më shumë se plani nëntëmujor. Kjo rritje është e ndikuar nga pagesat e tatimit në pronë gjegjësisht nga vërejtjet e fundit për obliguesit tatimor borxhlinj. Por të hyrat direkte dhe indirekte të komunës për periudhën raportuese kanë arritur vlerën prej 1,950,556.94 apo 155.53 % të planit vjetor. Ndërsa Granti i performancës me shumë prej: 1,519,623.94€, Gjobat e Komunikacionit në shumë prej: 397,285.5, gjobat e gjykatave në shumë prej: 33,647.50€ dhe Granti i Donatorve të brendshëm në shumë prej: 2,213.00 €.

Sqarim: Gjobat e gjykatave dhe komunikacionit akoma nuk na janë alokuar për tremujorin e tretë e që pritet të na alokohen(ndahen) në ditët në vazhdim.

1.2. Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore për këtë periudhë kanë arritur vlerën prej: 10,390,006.03 € përgjatë nëntëmuajorit të vitit 2023, apo 61.81 % të buxhetit të alokuar të komunës për vitin 2023. Ky shpenzim kryesisht është i ndikuar nga ekzekutimi më i lartë i shpenzimeve nga kategoria e pagave dhe mëditje për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave.

Shpenzimet për paga dhe mëditje gjatë këtij tremujori, shënuan vlerën prej 7,886,604.85 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 87.26 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori . Fatura e pagave gjatë periudhës raportuese, paraqet një rritje rreth. 1,107,989.35 € më shumë se plani vjetor, Ku nga kjo shumë për arsye të aprovimit të ligjit të ri për paga (562,790.16) dhe shtesa, si dhe vendime gjyqësore për kontratën Kolektive (545,199.19).

Shpenzimet në kategorinë ekonomike- mallëra dhe shërbime: Gjatë kësaj periudhe vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur shumën prej: 1,357,933.65 € apo 58.14 % të buxhetit të planifikuar për këtë kategori.

Shpenzimet në kategorinë ekonomike- Komunalë, kanë arrit shumën prej: 171,467.51 apo 53.20 % të buxhetit të planifikuar.

Shpenzimet për kategorinë ekonomike- subvencione dhe transfere, shënuan vlerën prej 241,109.50 € gjatë kësaj periudhe, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 57.40 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të alokimit të buxhetit të kësaj kategorie për këtë periudhë.

Shpenzimet kapitale janë realizuar me një normë jo të kënaqshme për shkak të situatës së krijuar me inflacionin i cili po ndikon në çdo lëmi. Ato arritën vlerën e realizimit prej: 2,635,370.28€, që është 30.24 % e buxhetit të alokuar për vitin 2023. Krahasuar me shpenzimet në këtë kategori gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2022 kemi rritje të shumës së shpenzuar për: 1,062,989.98 €.

Sa i përket buxhetimit gjinor mund të themi se përqindja e femrave në listen e të punësuarve arrin në 47.61 % dhe buxheti i pagave i shpenzuar për këtë kategori ka shkuar në këtë përqindje të shpenzimit (3,754,812.00). Gjithashtu komuna ka ndarë edhe subvencione për organizata jo qeveritare dhe për individ. Prej të gjithë përfituesve të subvencioneve, 65 përfitues janë femra (62 individ dhe 3 OJQ).

Nëse e analizojm raportin e të hyrave shihet se të hyrat e realizuara për këtë periudhë tejkalojnë planin vjetor për 251.71 %, (shuma e planifikuar 1,357,468.00€ ndërsa shuma e realizuar 3,416,843.87 €)

**Të hyrat vetanake deri tremujorin e tretë të vitit 2023 dhe krahasimi me vitet
paraprake**

Përshkrimi	2021	2022	2023	% me 2022
	në Euro			
1. GJITHSEJ TË HYRA	907,403.38	978,717.30	1,449,376.98	148.09
1.1. Të hyrat nga kodi 16301	85,157.04	91,354.57	94,525.50	103.47
Taksa për certifikata (50013-50016)	32,848.30	36,548.00	41,652.00	113.97
Vert.Fotok.dokumentacionit (50018)	435.00	681.50	490.50	71.97
Kerkesat 50019	7,129.00	5,583.28	4,753.00	85.13
Të Tjera 50413	-	-	200.00	-
Qeraja për Objektet Komunale 50408	44,744.74	48,541.79	47,430.00	97.71
1.2.Të hyrat nga kodi 16601	9,856.08	4,085.00	12,161.00	298.19
Të hyra nga Inspeksioni	9,856.08	4,085.00	12,161.00	297.70
1.3.Të hyrat nga kodi 17501	660,198.14	579,443.40	872,843.48	150.63
Tatimi në pronë 40110	579,284.14	492,492.40	780,083.48	158.40
Tax për regjistrimin e automjetit 50001	80,914.00	86,951.00	92,760.00	106.68
1.4. Të hyrat nga kodi 18001	3,110.00	4,560.00	17,369.00	380.90
Tax për parki.nga Sh.Publike 50008	3,110.00	4,560.00	11,653.00	255.55
Tax për treg të hapur-kafsheve 50406	-	-	5,716.00	-
Te hyrat nga kodi 47001	782.00	-	-	-
Tax nga Pylltaria 50107	782.00	-	-	-
1.6.Te hyrat na kodi 48001	6,762.00	123,776.50	138,242.60	111.69
Taksa ne firma 50201	6,762.00	123,776.50	138,242.60	111.69
1.7.Të hyrat nga kodi 65005	34,630.50	43,308.50	72,450.50	167.29
Tax regjistrim prone 50011	15,737.00	28,876.00	57,412.00	198.82
Tax fletposeduese kopje planit. 50012	18,177.50	14,383.50	15,038.50	104.55
Matje gjeodezike 50504	716.00	49.00	9,083.87	-
Taks për legalizim të objektev 50026			13,836.78	-
1.8.Të hyrat nga kodi 66310	48,094.62	87,504.63	190,444.40	217.64
Taks per leje ndertimi 50009	47,472.29	73,758.46	150,053.98	203.44
Shfrytzimi I pronës Komunale 50405	622.33	3,876.32	9,083.87	234.34
Tax per ndrrim te destinimit te tokës 50012	-	9,869.85	17,469.77	177.00
Tax për legalizim te objekteve 50026			13,836.78	-

1.9. Të hyrat nga kodi 73100	23,513.00	26,128.00	28,467.50	108.95
Participimi shendetësi	23,513.00	26,128.00	28,467.50	108.95
2.0. Te hyrat nga kodi 85001	610.00	60.00	25.00	83.33
Te hyrat nga qiraja e objekteve	610.00	60.00	25.00	41.67
2.1. Te hyrat nga kodi 92210	17,844.00	17,061.20	22,848.00	133.92
Participimi Arsimi	17,844.00	17,061.20	22,848.00	134.02
2.1 Të Hyrat Indirekte	983,662.90	906,090.41	1,950,556.94	215.27
Gjjobat e gjykatave	18,315.00	25,390.45	33,647.50	132.52
Gjjobat e komunikacionit	436,910.30	375,842.00	397,285.50	105.71
1.7.3 Donacion	528,437.60	504,857.96	1,519,623.94	301.00

Totali I të hyrav direkte dhe indirekte	3,399,933.92
--	---------------------

Shpenzimet për periudhën janar– shtator 2023 dhe krahasimi me vitet paraprake

Përshkrimi	2021	2022	2023	Buxheti për vitin 2023	% e shpenzimit
Vitet	1	2	3	4	Me vitin 2022
2. GJITHSEJ SHPENZIMI	9,587,863.67	6,807,817.68	12,292,485.79	18,156,892.00	180.56
Shpenzimet operative	7,548,877.93	6,073,053.94	9,416,006.01	11,695,797.00	143.09
2.1.1 Paga dhe mëditje	6,595,750.48	5,408,254.17	7,886,604.85	9,038,054.00	132.30
2.1.2. Mallra dhe shërbime	840,008.47	529,403.37	1,357,933.65	2,335,494.00	257.39
2.1.3 Shpenzime komunale	113,118.98	135,396.40	171,467.51	322,249.00	127.34
2.2 Subvencione dhe transfere	165,933.30	79,123.80	241,109.50	420,000.00	304.72

2.3 Shpenzime kapitale	1,873,052.44	655,639.94	2,635,370.28	5,914,095.00	401.95
2.3.1 Rezervat	-	-	-	127,000.00	0

Subvencionet deri në tremujorin e tretë dhe krahasimi me vitet parapake

Përshkrimi	2021	2022	2023	% me
	Shumat në Euro			2022
Zyra e kryetarit	2,200.00	2,000.00	6,000.00	300
DSHPE	105,220.00	50,848.45	41,104.50	80.84
D.Bujqësis	34,763.30	28,000.00	49,815.00	177.91
D.Zhvill ekonomik	-	23,000.00	12,000	0
D.Kultures	1,000.00	106,286.59	107,500.00	101.14
Drejtoria e Shëndetësisë	8,750.00	13,650.00	22,690.00	166.23
Drejtoria e Arsimit	14,500.00	349.9	2000	571.59
Gjithsej	165,933.30	224,134.94	241,109.50	107.57

Raporti i shpenzimeve kapitale Janar shtator 2023

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri TM3/2023	Mbetja	Progresi
					në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
18001	DSHPE				
53316	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve vendban.	40,000.00	20,000.00	20,000.00	50
53330	Rreg.dhe rrethimi I varrezave Drenas dhe Komoran	50,000.00	46,829.11	3,170.89	93.66
53341	Zgjerimi i kamerave Drenas dhe Komoran	5,000.00	672.50	5,000.00	13.45
53346	Rregullimi I trotuarve dhe parkingjeve Drenas dhe Komoran	5,000.00	1,000.00	5,000.00	20
53356	Rregullimi I tregjeve Drenas dhe Komoran	5,000.00	555.40	5,000.00	11.11
53364	Rregullimi dhe zgjerimi i vendndaljeve dhe mbulimi i tyre	10,000.00	9,766.50	233.5	97.67
50515	Rregullimi i sistemit të ujitjes për parkun e qytetit me gyp	50,000.00	-	50,000.00	-
53313	Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbruese	28,751.00	-	23,000.00	-
	GJITHSEJ	193,751.00	78,823.51	111,404.39	40.68

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet - TM3/2023	Mbetja	Progresi
					në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
18161	Drejtoria e Infrastruktures Publike				
48254	Rregullimi I shtratit të lumit Drenica dhe Verbica	34,876.17	30,000.00	0	86.02
48632	Asfaltimi I rrugës Gllanasellë, Godanc	70,000.00	34,845.00	35,155.00	49.78
48635	Asfaltimi I rrugës Paklek I Vjetër, I Ri, Vasilevë	70,000.00	21,258.00	48,742.00	30.37
48638	Asfaltimi I rrugës Dobroshec, Çikatovë e Vjetër	70,000.00	50,000.00	20,000.00	71.43

48643	Asfaltimi i rrugës në fshatrat Gradicë dhe Likoshan	70,000.00	26,834.01	43,165.99	38.33
48646	Asfaltimi i rrugës Arllat, Negroc, Gjergjicë dhe Bytyq	135,752.50	135,752.50	0	100
48648	Asfaltimi i rrugës Sankoc Fushticë	70,000.00	28,674.10	41,326	40.96
48653	Asfaltimi i rrugës Shtuticë, Verboc, Polluzhë	70,000.00	-	70,000.00	0
48656	Asfaltimi i rrugës Llapushnik, Poterk, Vukoc	70,000.00	40,000.00	30,000.00	57.14
48658	Asfaltimi i rrugës Z. ulët, Z. i Lartë, K. e Ulët dhe e Lartë	121,296.90	121,296.50	0	100
48661	Ndërtimi i kapaciteteve të ujësjellësit Drenas	270,000.00	45,131.23	224,868.77	16.72
48682	Bashkëfinancim projektesh me donator të jashtëm	55,000.00	-	55,000.00	0
48693	Kanalizimi i ujërave të zeza dhe atmosferike Drenasi I,II,III,IV	10,000.00	1,107.00	8,893.00	11.07
48694	Kanalizimi i ujërave të zeza Komorani I,II,III,IV	10,000.00	1,000.00	9,000.00	10
48705	Kanalizimi i ujërave të zeza Sankoc Fushticë e Epërme dhe e Ulët	15,109.00	15,109.00	0	100
48707	Kanalizimi i ujërave të zeza K.e Ulët, e Epërme dhe Paklek	10,000.00	1,000.00	9,000.00	10
48708	Kanalizimi i ujërave të zeza Dobroshec, Çikatovë e Vjetër	10,000.00	2,401.14	7,598.86	24.01
48709	Kanalizimi i ujërave të zeza Abri e Epërme, Tërdec	10,000.00	999.40	9,000.60	9.99
48710	Kanalizimi i ujërave të zeza Gllanasellë, Godanc	16,354.00	16,354.00	0	100
48711	Kanalizimi i ujërave të zeza Gradicë, Likoshan	10,000.00	999.14	9,000.86	9.99
48712	Kanalizimi i ujërave të zeza I lapushnik, Poterk, Vukoc	10,000.00	999.40	9,000.60	9.99
48713	Kanalizimi i ujërave të zeza Nekoc, Kishnarekë	14,669.00	14,669.00	0	100

49297	Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit Fehmi e Xhevë Lladrovci Dr.	1,513,735.22	150,000.00	1,363,735.22	9.91
49298	Kanalizimi I ujërave të zeza Krajkovë, Baicë, Damanek, Shtrubullojë	10,000.00	999.50	9,000.50	10
49299	Asfaltimi I rrugës Llapushnik Berishë	70,000.00	15,000.00	55,000.00	21.43
51322	Kanalizimi i ujërave të zeza Tersteniku I,II dhe Gllobar	10,000.00	7,574.50	2,425.50	75.75
51323	Kanalizimi I ujërave të zeza Shtuticë, Verboc, Polluzhë	11,933.50	11,923.50	10	99.92
51324	Asfaltimi I rrugëve Tërstenik I,II dhe Gllobar	70,000.00	-	70,000.00	0
51326	Kanalizimi I ujërave të zeza Arllat,Negroc, Gjergjicë dhe Bytyq	10,000.00	8,794.50	1,205.50	87.95
51340	Asfaltimi I rrugës Baicë, Krajkovë, Damanek, Shtrubullojë	70,000.00	-	70,000.00	0
52309	Ndërtimi I Rrugës Bregut te Qyqavices	70,000.00	-	70,000.00	0
52310	Ndërtimi I parkut dhe shtigjet për Këmbësor	250,000.00	119,990.00	130,010.00	48
53631	Ndërtimi I Kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza	350,000.00	322,336.80	27,663.20	92.1
53635	Rregullimi I trotuarëve dhe ndriqimit publik	280,000.00	214,147.40	65,852.60	76.48
53645	Asfaltimi I rrugëve dhe Kubzimi Drenas I,II,III,IV	320,000.00	-	320,000.00	0
53652	Asfaltimi I Rrugëve Komorani I,II,III,IV	100,000.00	59,485.50	40,514.50	59.49
53659	Ndërtimi I tombinave dhe mureve mbrojtëse	120,000.00	119,999.97	0.03	100
53660	Ndërtimi, zgjerimi dhe rekonstruimi I rrugëve të asfaltuara	443,649.00	119,118.89	324,530.11	26.85
53666	Ndërtimi,zgjerimi i rrjetit të kanalizimit	350,000.00	112,436.50	237,563.50	32.12
53670	Asfaltimi I rrugëve Abri dhe Terdec	70,000.00	-	70,000.00	0
53672	Asfaltimi I rrugëve Nekoc, Kishnarekë	70,000.00	65,474.68	4,525.32	93.54

53674	Hapja e kanaleve kulluese gjatë rrugve Drenas Komoran	25,000.00	22,701.01	2,298.99	90.8
92111	Performanca komunale 2021	59.51	-	59.51	0
92136	Mbeshtetja financiare e projekteve nga skema e grantit te performances komunale	400,953.90	356,104.73	44,849.17	88.81
92159	Granti I performances komunale 2023	1,118,387.08	-	1,118,387.08	0
	GJITHSEJ	6,956,775.78	2,294,516.90	4,657,382.31	32.98

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri me TM-3/2022	Mbetja	Progresi i TM-3/2022 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
47001	Bujqësia				
	Grant I donatorve te brendshem	2,213.25	-	2,213.25	-
	Gjithsejt	2,213.25	-	2,213.25	-

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri me TM-3/2022	Mbetja	Progresi i TM-3/2022 në %
66310	Urbanizmi				
53736	Vendosja e sistemit te adresave	5,000.00	-	5,000.00	-
53737	Gjelbrimi I hapsirav Publike	20,000.00	19,988.20	11.80	99.94
	GJITHSEJ	25,000.00	19,988.20	5,011.80	79.95

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri TM 3 /2023	Mbetja	Progresi në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
73100	QKMF				
53709	Rrethoja në QMF, AMF Komoran, Arllat, Nekoc, Terdec, Dobroshec	20,000.00	15,300.00	4,700.00	76.50

53716	Instalimi I nxemjeve nëpër QMF, AMF, Arllat, Gllanasellë, Nekoc, Tërdec	70,000.00	69,737.50	262.50	99.63
53721	Pjerrinat AMF, Arllat, Gllanasellë, Nekoc dhe Abri	10,000.00	10,000.00	-	100.00
53722	Paisje speciale mjeksore mbi 1000 €	300,000.00	-	300,000.00	-
53726	Vetura të ndihmes së shpejtë	115,000.00	58,499.99	11,500.01	50.87
	Gjithsej	515,000.00	153,537.89	316,462.51	29.81

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri TM3/2023	Mbetja	Progresi
					në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
85001	Drejtorja e Kulturës				
53738	Ndërtimi i Parkingut, Rrethojat, Fusha Sintetike në Drenas	20,000.00	19,768.20	231.80	98.84
53739	Fusha sportive dhe rekreacion, Dritan, Llapushnik dhe Terstenik	115,000.00	6,430.00	108,570.00	5.59
89114	Ndërtimi i Stadiumit Faza e Dytë	400,000.00	22,555.57	377,445.00	5.64
	Gjithsej	535,000.00	48,753.77	521,158.70	2.59

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet deri TM3/2023	Mbetja	Progresi
					në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
93000	Arsimi Fillor				
53684	Dixhitalizimi I shkollave softwer, F,Lladrovci	60,000.00	-	60,000.00	-
53686	Paisje të Tik-ut R.Kiqina, F.Lladrovci, A.Bujupi, Xh.Gashi, A.Gashi	60,000.00	-	60,000.00	-
53689	Ndërtimi I Parkingjeve dhe Pllatove SH.Galica, G.Syla, 7 Marsi	30,000.00	-	30,000.00	-
53691	Ndërtimi I fushave të jashtme dhe rrethojave G.Elshani	40,000.00	39,750.01	249.99	99.38

53696	Këndi për lojëra dhe rekreacion Z.Hajdini, QEAP Ardhmeria, R.Kiqina	40,000.00	-	40,000.00	-
53700	Ndërtimi i rrethojave të shkollave, Nyjeve sanitare, ngjyrosja	78,000.00	-	78,000.00	-
53706	Instalimi i nxemjeve qendrore G.Syla, Z.Hajdini,	14,000.00	-	14,000.00	-
53687	Kabineti në SHFMU D.Drenices, F.Lladrovci, D.Fortesës	50,000.00	-	50,000.00	-
	Gjithsej	372,000.00	39,750.01	332,249.99	10.69

611	GJITHSEJ KOMUNA	8,599,740.03	2,635,369.88	5,964,370.15	30.64
-----	------------------------	---------------------	---------------------	---------------------	--------------



Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës



**Republike e Kosovës
Komuna e Glogocit
Zyra e Kryetarit**



Nr.01- 432101-49342 ,dt. 04/10 /2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Neni 9 dhe neni 10 paragrafi 2 i Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, si dhe në bazë të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon këtë:

PROPOZIMVENDIM

Për plotësim ndryshimin e caktimit të normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024

Neni 1

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, dhe paragrafin 2 të nenit 10, Kuvendi Komunal i Komunës së Glogocit cakton normat tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- Për njësitë bujqësore të parcelave-----0.10%
- Për njësitë bujqësore të objekteve-----0.10%
- Për njësitë pyjore të parcelave-----0.10%
- Për njësitë rezidenciale të parcelave-----0.10%
- Për njësitë rezidenciale të objekteve-----0.10%
- Për njësitë komerciale të parcelave-----0.10%
- Për njësitë komerciale të objekteve-----0.10%
- Për njësitë industriale të parcelave-----0.10%
- Për njësitë industriale të objekteve-----0.10%

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë, dhe fillon së zbatuari nga 1 janari 2024.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

Zyrës së Kryetarit;

Zyrës së Kuvendit

Drejtrosë Përkatesë;

Arkivit;



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci
Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Në zbatim të Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 2 i nenit 10, Kuvendi Komunal i Komunës së Glllogocit cakton normat tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave.

Si dhe sipas kërkesës së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për rishqyrtim të ligjshmërisë nr.1919-1/2023 të dt.27.09.2023, me të cilën kërkesë ka kërkuar që të plotësohet ndryshohet vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e Paluajtshme për vitin 2024, nr.02-432-01-43976 të dt.31.08.2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive


Nr. i Orig. 02KCM/18
Org. Jedin. 1919-1/2023
Org. Unit
Nr. i Kopje 5
Broj stranica
No. pages: 27, 09/2023
Dati
Date: PRISTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit	
	Milaim Hajdari, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës	
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Resul Makreshi, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Klit Shala, Zv. Drejtör i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Zyrtarët përgjegjës:	Razije Murtezaj, Zyrtares Ligjore, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Vehap Hashani, Zyrtar i Lartë Ligjor, Departamenti i Tatimit në Pronë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim	



I nderuari Kryetar z. Lladrovci,
I nderuari Kryesues z. Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendimin 02 Nr.432/01-43976 për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024</i>
<i>I miratuar më datë 31.08.2023</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 01.09.2023</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 13.09.2023</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "**Ministria**"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Glllogocit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Glllogocit, me anë të aktit që është subjekt i shqyrtimit, synon caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike.
2. Si pikë e parë, dhe për qëllime të këtij vlerësimi është me rëndësi të theksohet se neni 9 i Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal i autorizon Komunitat që të mbledhin tatimin në pronat e paluajtshme, të cilat ndodhen brenda kufijve territoriale të saj.
3. Për të konkretizuar konstatimin e mësipërm, si dhe tregues i rëndësishëm për të vlerësuar caktimin e normave tatimore për kategoritë e pronave nga Komunitat mbetet Ligji nr. 08/l-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/l-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, ku ndër tjerash, precizohen edhe konditat ligjore për caktimin e rregullt të normave tatimore.
4. Relevante për rastin konkret është paragrafi 1 i nenit 9 të Ligjit, ku precizohet qartë se:


"Kuvendi komunal i çdo komune cakton normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, deri më 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit në përpjethje me këtë Ligj."

5. Nëse elaborohet vlerësimi ligjor krahas frymës së me nenin 9 (nenin 39/A) dhe 10 par. 2 të Ligjit Nr. 08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, të cilat parashohin se për vitin tatimor 2024 vlen rregullimi i normave tatimore si për vitin tatimor 2023 pra duke i ndarë normat sipas kategorive të pronave, por në dallim prej vitit tatimor 2023, minimumi i normës tatimore ka zbritur nga 0,15% në 0,10%. Ndërsa, normat tatimore progresive hyjnë në fuqi nga viti tatimor 2025 *Komuna nuk ka vepruar në konformitet me konditat ligjore procedurale të përcaktuara me këtë Ligj.*
6. Si përfundim, ky Vendim është në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 10 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.
